




KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A me seli në Prizren, në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin të mbajtur me datë 16.05.2024, miratoi:



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA PËR VITIN 2023 DHE LETRËN PËR MENAXHMENTIN NGA AUDITORI I PAVARUR.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve miratoi Pasqyrat Financiare të audituara nga Auditori i Pavarur në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin të mbajtur me datë 16.05.2024.

	Delegoi	Aprovoi
<i>Emri dhe Mbiemri</i>	<i>U.D Kryeshefi Ekzekutiv, z. Fadil Berisha</i>	<i>Kryesuesi i BpD Ismet Vrapcani</i>
<i>Nënshkrimi</i>		
<i>Data</i>	16.05.2024	16.05.2024



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
DEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

Njesia Org: 0113 Nr. Prof: 4698
Org. Jedin: Org. Unit: Prof. No:
Nr. i faqesve: 37 Data: 04.05.24
Broj stranica: Datum: 04.05.24
No. pages: No. 1
PRISHTINE / A

KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.

Nr. 1955
Dt. 16.05.2024
PRIZREN

KOMPANIA RAJONALE E UJIT
HIDROREGJIONI JUGOR SH.A

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur
31 dhjetor 2023**

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	12 – 36



RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhmentit dhe Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujit HIDROREGJIONI JUGOR Sh.A.

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Kompanisë Rajonale të Ujit HIDROREGJIONI JUGOR Sh.A (në vijim referuar si "Kompania" apo "KRU HIDROREGJIONI JUGOR") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2023, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshirë në faqet 8-36.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafin Baza për opinion me rezerve pjesë e raportit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2023, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion me rezervë

1. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 8 të pasqyrave financiare përcjellëse, vlera e Prones, Impianteve dhe Pajimeve të Kompanisë më 31 Dhjetor 2023 është 32,103 mijë EUR (31 Dhjetor 2022; 32,426 mijë EUR). Kompania ka rivlerësuar vlerën e Prones, Impianteve dhe Pajimeve në vitin 2020. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të përcaktonim nëse rivlerësimi i kryer është bërë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 Prona, Impiantet dhe Pajimet dhe të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e në vlerën bartese të objektit.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe Ligjin nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për kërkesat specifike në lidhje me auditimin ligjor të subjekteve me interes publik. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin të një rëndësie më të madhe në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tone më sipër, dhe ne nuk do të japin një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Çështje tjera	Si i adresoj auditimi ynë çështjet tjera
<p>Përcaktimi i normes së zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve</p> <p>Prona, impiantet dhe pajisjet më 31 dhjetor 2022 arrijnë një vlerë neto prej 32,26 mijë euro e cila përbën 90% të gjithsej pasurive. Zhvlerësimi i akumuluar arriti në 17,793 mijë euro.</p> <p>Ne kemi identifikuar përcaktimin e jetëgjatësisë së pronës, impianteve dhe pajisjeve si çështje kryesore të auditimit, sepse kërkohet nga menaxhmenti të ushtrojë gjykim të rëndësishëm në lidhje me përcaktimin e jetëgjatësisë së pasurive duke konsideruar natyrën, kohën dhe gjasat e ndryshimit të faktorëve teknik të cilët mund të ndikojnë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe prandaj mund të ketë një ndikim material në shpenzimet e zhvlerësimit për vitin.</p> <p>Ne i referohemi shënimeve të pasqyrave financiare 3.6 dhe 4 Prona, impiantet dhe pajisjet.</p>	<p>Auditimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve ishte një kombinim i auditimit të kontrolleve dhe procedurave thelbësore të auditimit. Përgjigjja jonë e auditimit është si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ne kemi marrë një kuptueshmeri mbi gjykimin e menaxhmentit në lidhje me vlerësimet për përcaktimin e normës së zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe kemi testuar kontrollet kryesore. - Mbi bazën e një mostre, ne kemi zgjedhur dhe krahasuar jetën e dobishme të pasurisë në vitin aktual me vitin paraprak për të përcaktuar nëse ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në jetën e dobishme të pasurive dhe kemi konsideruar arsyeshmërinë e ndryshimeve bazuar në njohuritë tona për biznesin dhe industrinë. - Sa i përket shtesave të pasurive, ne kemi testuar nëse shtesat (blerjet) janë klasifikuar në kategorinë e duhur, fillimi i zhvlerësimit ka ndodhur në kohën e duhur dhe jeta ekonomike e përcaktuar ishte në përputhje me jetën ekonomike të përdorur nga kompania dhe të paraqitura në politikat e kontabilitetit. - Ne kemi sfiduar supozimet dhe gjykimet kritike të përdorura nga menaxhmenti duke krahasuar vlerësimet dhe planet e kaluara të menaxhmentit me vlerësimet dhe planet e vitit aktual. - Ne kemi vlerësuar përshtatshmërinë e shpalosjeve të Kompanisë në lidhje me pronën, impiantet dhe pajisjet.
<p>Vlerësimi i llogarive të arkëtueshme tregtare</p> <p>Të arkëtueshmet tregtare njihen me vlerën e tyre të parashikuar të realizueshme, e cila është shuma origjinale e faturuar minus provizioni i vlerësuar i zhvlerësimit. Vlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare është një çështje kryesore e auditimit për shkak të madhësisë së balancës së të arkëtueshmeve tregtare dhe nivelit të lartë të gjykimin të menaxhmentit të përdorur në përcaktimin e provizioneve të dëmtimit.</p> <p>Ne i referohemi shënimit 6 në pasqyrat financiare Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera dhe shënimit 20 B.</p>	<p>Procedurat tona të auditimit paraqiten si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ne vlerësuar procedurat e kontrollit kreditor të Kompanisë dhe vlerësuar dhe vërtetuam vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme tregtare. - Ne e vlerësuar rikuperueshmërinë në bazë të një mostre duke ju referuar arkëtimit të pranuar pas fundit të vitit dhe marrëveshjes me kushtet e kontratës në fuqi. - Ne kemi marrë në bazë të mostrës konfirmimet nga palët e treta dhe kemi rakorduar diferencat. - Ne kemi konsideruar përshtatshmërinë e gjyqimeve në lidhje me lejimet e zhvlerësimit për

	<p>të arkëtueshmet tregtare dhe kemi vlerësuar përshtatshmërinë e tyre.</p> <p>- Ne kemi konsideruar plotësinë dhe saktësinë e shpalosjeve.</p>
--	---

Theksim i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 19 të pasqyrave financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore të Kompanisë nuk janë audituar nga Autoriteti tatimor për vitin që përfundon që 31 Dhjetor 2022. Si rrjedhojë e kësaj, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen të finalizuara. Provizionet për taksat shtesë dhe gjobot, nëse ka ndonjë, nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare individuale

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të



shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Informatat tjera

Informatat tjera përfshijnë Raportin e menaxhmentit, se bashku me një Deklaratë të qeverisjes Korporative të Organizatës ashtu siç kërkohet nga neni 7 i Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat përbejnë pjesë të veçantë të raportit për vitin financiar që përfundon me 31 Dhjetor 2023.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për informatat tjera

Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit të përfshirë në raportin vjetor.

Përgjegjësitë e auditorit

Mendimi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe, përveç në masën e deklaruar në mënyrë të shprehur në raportin tonë, ne nuk shprehim ndonjë konkluzion sigurie në të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është që të lexojmë informacionin tjetër, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit kemi marrë parasysh nëse ai përfshin shpalosjen e kërkuar nga Ligji Nr. 06 / L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin, Neni 10. Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme sipas mendimit tonë:



Opinionin mbi raportin e Menaxhmentit

Bazuar ne punën tonë te kryer gjate auditimit, opinionin jone është se raporti i Menaxhmentit:

- është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, neni 10 dhe
- është ne përputhje me informacionin e përfshirë ne pasqyrat financiare.

Për me tepër, ne njohuritë e te kuptuarit tone te Kompanise dhe mjedisit te saj të marrë gjatë auditimit, ne nuk kemi identifikuar ndonjë keqpohim material te Raportit te Menaxhmentit.

Opinion mbi Deklaratën e Qeverisjes Korporative

Në opinionin tonë, Deklarata e Qeverisjes Korporative te Kompanise përmban te gjitha informacionet siç kërkohet nga neni 7 i ligjit dhe është ne përputhje me informacionin e përfshirë ne pasqyrat financiare.

Raport mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative


Deklaratë në lidhje me ofrimin e shërbimeve jo te auditimit

Në më të mirën e njohurive dhe besimit tonë, ne sigurojmë që nuk kemi ofruar asnjë shërbim jo-auditues të cilat janë të ndaluara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2020 për Pavarësinë e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave te Auditimit.

Emërimi i auditorit

Ne u emëruam si Auditor të Pasqyrave financiare te Organizatës me 24 Nëntor 2022. Ne konfirmojmë se nga këndvështrimi i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, ky është viti i dytë që ne po ofrojmë shërbime të auditimi për pasqyrat financiare të Kompanisë.

Audit & Conto


Ymer Shatri
Partner Angazhimi
29 Prill, 2024



KRU HIDROREGJIONI JUGOR SH.A
Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimi	31 Dhjetor 2023 (në EUR 000)	31 Dhjetor 2022 (në EUR 000)
ASETET			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	32,103	32,352
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	9	-	-
Asetet e paprekshme	5	60	74
		32,163	32,426
Asetet qarkulluese			
Stoqet	6	580	545
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	7	931	1,003
Paraja në dorë dhe në bankë	8	1,456	1,849
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurter	9	-	-
Te arkëtueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		-	-
		2,967	3,397
Gjithsej asetet		35,130	35,823
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitall aksionar	10	25	25
Rezervat	11	19,527	19,860
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar		(6,091)	(6,190)
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		13,461	13,695
Detyrimet			
Detyrimet jo-qarkulluese			
Huamarrjet – pjesa afatgjatë	12	-	-
Grantet e shtyera	13	20,082	20,121
	14	-	-
Detyrimet e shtyera tatimore	25	-	-
		20,082	20,121
Detyrimet qarkulluese			
Huazimet – pjesa afatshkurtër	12	-	-
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	15	1,387	1,902
Tatimi ne te ardhura l pagueshem		-	-
Detyrimet tjera		135	38
Provizionet	16	65	66
		1,587	2,006
Gjithsej detyrimet		21,669	22,127
Gjithsej kapitali dhe detyrimet		35,130	35,823

Ztr. Fadil Berisha

U.D. Kryeshef Ekzekutiv



Ztr. Ruzhdi Baftjaraj

Zyrtar Kryesor i Financave
dhe kontabilist i certifikuar

Shënimet e bashkangjitura prej 8 deri në 35 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

KRU HIDROREGJIONI JUGOR SH.A**Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse**

	Shënimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
		(në EUR 000)	(në EUR 000)
Të hyrat nga shitjet	17	5,495	5,274
Të hyrat nga grantet	18	380	368
Te hyrat nga subvencionet		14	-
Të hyrat tjera	19	22	237
		5,911	5,879
Shpenzimet operative			
Zhvlërimi dhe amortizimi	4,5	(1,291)	(1,258)
Shpenzimet e personelit	20	(2,880)	(2,487)
Energjia elektrike	21	(1,016)	(935)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(233)	(216)
Shpenzimet e prodhimit të ujit		(43)	(62)
Provizionet ligjore	6	-	(66)
Humbjet nga zhvlërimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		(166)	(481)
Shpenzimet e derivateve	14	(118)	(135)
Shpenzimet e tjera operative	22	(366)	(262)
		(6,113)	(5,902)
Fitimi nga operacionet		(202)	(23)
Shpenzimet/ (të hyrat) financiare,neto	23	(32)	(36)
Fitimi para tatimit		(234)	(59)
Tatimi në fitim	24	-	-
Fitim neto për vitin		(234)	(59)
Te hyra tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Zërat që nuk klasifikohen në fitim apo humbje			
Te ardhurat e liruara nga rivlerësimi i pronës, impianteve dhe paisjeve	25	333	343
Gjithsej te hyra gjithëpërfshirëse për vitin		99	284

Shënimet e bashkangjitura prej 8 deri 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

KRU HIDROREGJIONI JUGOR SH.A**'asqyra e ndryshimeve ne ekuitet**

	Kapitali aksionar (në EUR' 000)	Rezervat (në EUR' 000)	(Humbjet) e akumuluar (në EUR' 000)	Gjithsej (në EUR' 000)
Gjendja me 1 Janar, 2022	25	20,203	(6,474)	13,754
Transaksionet me pronaret	-	-	-	-
Dividenda	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	(343)	(59)	(59)
Te hyra gjithëpërfshirë tjera	-	(343)	343	(59)
Total te hyra gjithëpërfshirë	-	(343)	284	(59)
Gjendja me 31 Dhjetor, 2022	25	19,860	(6,190)	13,695
Gjendja me 1 Janar, 2023	25	19,860	(6,190)	13,695
Transaksionet me pronaret	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	-	(234)	(234)
Te hyra gjithëpërfshirë tjera	-	(333)	333	-
Total te hyra gjithëpërfshirë	-	(333)	99	(234)
Gjendja me 31 Dhjetor, 2023	25	19,527	(6,091)	13,461

shënimet e bashkangjitura prej 8 deri 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

KRU HIDROREGJIONI JUGOR SH.A
Pasqyra e rrjedhës së parasë për fund vitin 31 Dhjetor 2023

		2023	2022
	Shënimet	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto para tatimit		(234)	(59)
Rregullimet për zërat jomonetar		-	-
Zhvlërësimi dhe amortizimi	4,5	1,291	1,258
Amortizimi i granteve	17	(380)	(368)
Të hyrat nga interesi	22	-	-
Shpenzimet e interesit	22	-	-
Provizionimi i borxheve të këqija	27.B	166	481
Provizionimi për rastet gjyqesore	13	-	66
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	-	-
Shlyerja direkte e pasurive të tjera		-	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	-	-
Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		843	1,378
Inventarët			
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(35)	57
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		(94)	(114)
		(420)	(732)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		294	589
Interesi i arkëtuar		-	-
Interesi i paguar		-	-
Tatimi mbi të ardhura i paguar		-	-
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		294	589
Paraja nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(1,029)	(785)
		-	-
Zvogëlim/(Rritje) në depozita		-	-
Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive		(1,029)	(785)
Paraja nga aktivitetet financiare			
Grantet e pranuar		341	697
Dividenda e paguar	9.1	-	-
Pagesa e huazimeve	11	-	-
Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare		341	697
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë		(394)	501
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		1,849	1,348
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	8	1,456	1,849

Shënimet e bashkangjitura prej 8 deri 36 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A., Prizren (Kompania) është shoqëri aksionare e inkuorporuar në Kosovë, më 29 Maj 2007, si vazhdimsi e Projektit për Korporatizimin e Sektorit të Ujit në Kosovë. Kompania është vartëse në pronësi të plotë e Kompanisë Rajonale të Ujit "Hidroregjioni Jugor" Holding SH.A. dhe pasardhëse legale e Kompanisë Publike KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A., Prizren. Adresa e zyrës qendrore të regjistruar është rr. Vatrart shqiptare p.n., Prizren, Kosovë.

Kapitali fillestar i regjistruar i Kompanisë është 25,000 Euro. Librat e Kompanisë janë hapur më 01 Janar 2007 bazuar në Pasqyrën e Gjendjes Fillestare, pastaj Raporti i Studimit Financiar po ashtu edhe të dhënat nga vlerësimi i bërë me 01 Janar 2007 nga Consortium Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP USA New York dhe Grant Thornton Consulting DOO Maqedoni – Shkup ("Konsortiumi").

Kompania mbledh, pastron dhe shpërndan ujin në komunat e Prizrenit, Suharekës, Dragashit dhe Malishevës. Numri mesatar i të punësuarve të Kompanisë gjatë vitit 2023 është 327 (2022; 328).

2. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombëtarë**Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara**

Nga njoftimet kontabël e shpallura, për standardet që hyjnë në fuqi pas 1 janari 2023, nuk ka pasur ndryshime që të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Standarde dhe ndryshime të tjera që janë efektive për herë të parë pas datës 1 Janar 2023 dhe mund të zbatohen për njësinë ekonomike janë:

SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17

SNRF 17 kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matjeje dhe paraqitjeje për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë krijuar për të arritur qëllimin e një kontabiliteti konsistent dhe të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 kontratat e sigurimit që nga 1 janari 2023.

SNRF S1 Kërkesat e Përgjithshme për Dhënien e Informacionit Financiar të lidhur me Qëndrueshmërinë

SNRF S1 përcakton kërkesat e përgjithshme për dhënien e informacioneve shpjeguese financiare të lidhura me qëndrueshmërinë me objektivin që t'i kërkojë një njësi ekonomike të japë informacione rreth rreziqeve dhe mundësive të lidhura me qëndrueshmërinë që është e dobishme për përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme në marrjen e vendimeve në lidhje me sigurimin e burimeve për entitet. Zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

SNRF S2 Dhënia e informacioneve shpjeguese të lidhura me klimën

SNRF S2 përcakton kërkesat për identifikimin, matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese rreth rreziqeve dhe mundësive të lidhura me klimën që është i dobishëm për përdoruesit kryesorë të raporteve financiare për qëllime të përgjithshme në marrjen e vendimeve në lidhje me sigurimin e burimeve për njësinë ekonomike.

Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Ndryshimet në SNK 1)

Ndryshimet synojnë të nxisin konsistencën në zbatimin e kërkesave duke ndihmuar kompanitë të përcaktojnë nëse, në pasqyrën e pozicionit financiar, borxhi dhe detyrimet e tjera me një datë të pasigurt shlyerjeje duhet të klasifikohen si rrjedhëse (të vonuara ose potencialisht për t'u shlyer brenda një viti) ose joaktual. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

Ndryshimet në SNRF 17

Ndryshon SNRF 17 për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pas publikimit të SNRF 17 Kontratat e Sigurimit në 2017. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023.

Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF)

Ndryshimet kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për politikat e saj kontabël materiale, në vend të politikave të saj të rëndësishme kontabël. Ndryshime të mëtejshme shpjegojnë se si një njësi ekonomike mund të identifikojë një politikë kontabël materiale. Shtohen shembuj se kur një politikë kontabël ka të ngjarë të jetë materiale. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023.

Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime në SNK 8)

Ndryshimet zëvendësojnë përkufizimin e një ndryshimi në vlerësimet kontabël me një përkufizim të vlerësimeve kontabël. Sipas përkufizimit të ri, vlerësimet kontabël janë "shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë së matjes". Njësitë ekonomike zhvillojnë vlerësime kontabël nëse politikat kontabël kërkojnë që zërat në pasqyrat financiare të maten në një mënyrë që përfshin pasiguri në matje. Ndryshimet sqarojnë se një ndryshim në vlerësimin kontabël që rezulton nga informacione të reja ose zhvillime të reja nuk është korrigjim i një gabimi. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023.

Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12)

Ndryshimet sqarojnë se përjashtimi nga njohja fillestare nuk zbatohet për transaksionet në të cilat shuma të barabarta të diferencave të përkohshme të zbritshme dhe të tatueshme lindin në njohjen fillestare. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023.

Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 — Informacion krahasues (Amendamenti i SNRF 17)

Amendamenti i lejon njësitë ekonomike që së pari zbatojnë SNRF 17 dhe SNRF 9 në të njëjtën kohë të paraqesin informacion krahasues rreth një pasurie financiare sikur kërkesat e klasifikimit dhe matjes të SNRF 9 të ishin zbatuar më parë për atë pasuri financiare. Një njësi ekonomike që zgjedh të zbatojë amendamentin e zbaton atë kur zbaton për herë të parë SNRF 17.

Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)

Amendamenti sqaron se si një shitës-qiramarrës mat më pas transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira që plotësojnë kërkesat e SNRF 15 për t'u kontabilizuar si shitje. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)

Amendamenti sqaron se si kushtet me të cilat një njësi ekonomike duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi. Periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

3.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike përveç rastit të rivlerësimit të disa aseteve dhe detyrimeve financiare, siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit. Kostoja historike është e bazuar në përgjithësi në shumën e dhënë në këmbim të pasurisë. Këto janë pasqyra financiare individuale të organizatës që synojnë të përdoren kryesisht për përmbushjen e raportimeve staturore.

3.3 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

3.4 Valuta funksionale dhe prezentimit

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

3.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e denominuara në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

3.6 Prona, impiantet dhe paisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve më 1 Qershor 2020 janë rivlerësuar dhe paraqitur në vlerën e tyre sipas rivlerësimit, ndërsa zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve të blera mbas periudhës 1 qershor 2020 paraqiten me kosto zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka.

Kostoja e ri vlerësuar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur më 1 qershor 2020.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Zhvlerësimi në pasuritë është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

Ndërtesat	5%
Pajisje dhe makineria e rëndë	15%
Automjetet, kompjuterët, pajisjet e zyrës, etj	20%

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një pasurie është rritur menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

3.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

3.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

3.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare

Në secilën datë të raportimit, Kompania rishikon vlerat kontabël të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion që ato pasuri kanë pësuar një dëmtim nga humbjet. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shumta e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së dëmtimit (nëse ka). Kur pasuria nuk gjeneron fluks të parave që janë të pavarura nga pasuritë e tjera, Kompania vlerëson shumën e rikuperueshme të njësive gjeneruese të parave të cilës i përket pasuria. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, pasuritë e korporatave u shpërndahen edhe njësive individuale të gjenerimit të parave, ose përndryshe ato shpërndahen në grupin më të vogël të njësive gjeneruese të parave për të cilat mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme të alokimit.

Shumta e rikuperueshme është më e lartë se vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të pasurisë dhe rreziqet specifike për pasurinë për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave nuk janë rregulluar.

Nëse shumta e rikuperueshme e një pasurie (ose njësi gjeneruese të parave të gatshme) vlerësohet të jetë më e vogël se vlera e tij kontabël, vlera kontabël e pasurisë (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse pasuria përkatëse mbahet me një shumë të rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si një rivlerësim dhe në atë masë që humbja e dëmtimit është më e madhe se teprica e rivlerësimit të lidhur, humbja e tepërt nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje.

Kur një humbje nga dëmtimi shfuqizon më pas, vlera kontabël e një pasurie (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) është rritur në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të tij, por në mënyrë që vlera e shtuar kontabël të mos kalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar nuk do të kishte asnjë humbje nga dëmtimi që do ishte njohur për pasurinë (ose njësinë gjeneruese të parave të gatshme) në vitet e mëparshme. Një kthim i humbjes nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje në atë mënyrë që eliminon humbjen nga dëmtimi i cili është njohur për pasurinë në vitet e mëparshme. Çdo rritje më të madhe se kjo shumë është trajtuar si një rritje të rivlerësimit.

3.10 Asetet dhe detyrimet financiare

Kompania klasifikon investimet e saj në kategoritë e mëposhtme: asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huave dhe llogarive të arkëtueshme, të mbajtura deri në maturim asetet financiare dhe asetet në dispozicion për shitje financiare. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin investimet janë të fituara. Menaxhimi i përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

a) Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregtim dhe atyre të përcaktuar në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aset financiar klasifikohet në kategorinë e "aseteve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" në fillim nëse është përfutur kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, nëse ajo është pjesë e një portofoli të asetëve financiare në të cilat ka prova afatshkurtër fitim-marrjen, ose në qoftë se kështu i caktuar nga Menaxhmenti. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

b) Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë jo-derivative asete financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre që kompania synon të shesë në afat të shkurtër ose ajo i ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes apo në dispozicion për shitje. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pastaj me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, duke zbritur provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të huave dhe llogarive të arkëtueshme është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.

Te Arkëtueshmet tregtare janë klasifikuar në këtë kategori. Ato njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas në shumat e rikuperueshme, minus provizioni për dëmtim. Një dispozitë për provizionimin e të arkëtueshmeve tregtare është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të arkëtimit. Vështirësi të mëdha financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar dhe mosveprimi apo delikuenca në pagesa (më shumë se 30 ditë vonesë) janë konsideruar si tregues që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtar.

Shuma e mbartur e aktivitetit nëpërmjet përdorimit të një llogarie provizioni, dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, ajo shlyhet kundër llogarisë së provizionit të të arkëtueshmeve tregtare. Ri kthimet pasuese të shumave të shlyera më parë kreditohen në fitim ose humbje.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

C) Asetet financiare te mbajtura deri ne maturim

